

KONTRATË SHITBLERJE KUOTE KAPITALI

Sot më datë 11.08.2025 (dymijë e njëzet e pesë), palët kontraktuese të poshtëshënuara, hartojnë këtë kontratë shitblerje kuote kapitali në përputhje me dispozitat e Kodit Civil, ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar), ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" (i ndryshuar) dhe statutit të shoqërisë "AZEL" SHPK, me kushtet e mëposhtme:

I. PALËT

Pala Shitëse:

z. Skënder Pashaj, shtetas shqiptar, lindur më 23.02.1970, në Durrës dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

Pala Blerëse:

z. Igli Pulleja, shtetas shqiptar, lindur më 21.09.1990, në Tiranë dhe banues në Tiranë, madhor, me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit bashkëlidhur kësaj kontrate.

Kushtet Paraprake

1) Shoqëria "AZEL" SHPK, shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, është regjistruar si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit më datë 14.02.2025, e pajisur me Certifikatë Regjistrimi NUIS (NIPT) M51414012; me zyrë qendrore në Tiranë, Valias, Zona kadastrale 1649, nr. pasurie 32/10, volumni 4, faqe 211, Kamëz-Tiranë, me kapital të regjistruar ALL 5,000,000 (pesë milion lekë); me 2 ortakë, z. Ardian Shashaj zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë dhe z. Skënder Pashaj, zotërues i 1 (një) kuote e cila përbën 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

2) Pala shitëse është e interesuar të shesë kuotën e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "AZEL" SHPK dhe pala blerëse është e interesuar të blejë këtë kuotë;

Për sa më lart palët bien dakord, për sa vijon:

II. OBJEKTI

2.1 Nëpërmjet kësaj kontrate pala shitëse z. Skënder Pashaj, i shet palës blerëse z. Igli Pulleja kuotën që ai zotëron në shoqërinë "AZEL" SHPK dhe e cila përbën 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.

2.5 Pas regjistrimit të kësaj kontrate dhe pasqyrimit të ndryshimeve në fletën e regjistrimit të shoqërisë, përbërja e ortakërisë së shoqërisë "AZEL" SHPK, do të jetë si më poshtë vijon:

- Z. Ardian Shashaj, do të jetë zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.
- Z. Igli Pulleja, do të jetë zotërues i 1 (një) kuote e cila përfaqëson 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë.



III. ÇMIMI

3.1 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës që z. Skënder Pashaj zotëron në shoqërinë "AZEL" SHPK, objekt i kësaj kontrate, është në total ALL 2,500,000 (dy milion e pesëqind mijë lekë).

3.2 Palët bien dakord që çmimi i shitjes së kuotës objekt i kësaj kontrate do të paguhet brenda 2 (dy) vjetëshi, afat ky që fillon nga dita e nënshkrimit të kësaj kontrate. Palët kanë rënë dakord që çmimi do të paguhet nga pala blerëse me kështu ose tërësisht, por gjithësesi brenda vitit të parë të kësaj kontrate blerësi duhet të ketë paguar minimalisht gjysmën e çmimit të kontratës.

IV. TË DREJTA DHE DETYRIME TË PALËVE

4.1 Pala blerëse detyrohet të paguajë çmimin e kontratës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 3.2 të kësaj kontrate. Për zgjatjen e këtij afati palët duhet të bien në dakordësi midis tyre.

4.2 Palët kësaj kontrate detyrohen që asnjëra prej tyre të mos tërhiqet nga kjo kontratë. Në rast se ndonjëra prej palëve tërhiqet nga kontrata apo kryen ndonjë veprim me qëllim mosplotësimin e kushteve të përcaktuara në dispozitat e kësaj kontrate, atëherë pala që tërhiqet ose kryen veprimin, detyrohet t'i paguajë palës tjetër një penallitet sipas ligjit.

V. KALIMI I PRONËSISË

5.1 Palët kanë rënë dakord që kjo kontratë shpërblejë kuotën kapitale, pavarësisht se çmimi i saj do të paguhet sipas parashikimeve të nenit 3.2 të kontratës, do të regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) pas nënshkrimit të saj dhe kuota do të kalojë nga pala shitëse tek pala blerëse menjëherë.

5.2 Në referim të dispozitave të Kodit Civil dhe ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate pronësia kalon nga pala shitëse tek pala blerëse.

5.3 Pas regjistrimit të kësaj kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit, pasqyrohet në fletët e regjistrimit të shoqërisë, duke u bërë publike për të tretët fakti, se pronësia mbi kuotën e cila përbën 50% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "AZEL" SHPK, do të kalojë nga pala shitëse Skënder Pashaj, tek pala blerëse Igli Pulleja.

5.4 Nga momenti e nënshkrimit të kësaj kontrate pala shitëse, humbet çdo të drejtë pronësie mbi kuotën e cila përfaqëson 50% të kapitalit të shoqërisë "AZEL" SHPK dhe këto të drejta firohen nga pala blerëse.

Kjo kontratë hartohet në 3 (tre) origjinale në gjuhën shqipe, nga të cilat një origjinal regjistrohet në Zyrën e Regjistrimit Tregtar, pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) dhe më pas qëndron në zyrën qendrore të shoqërisë dhe nga një origjinal e merr secila palë.

Kontrata pasi u lexua me zë të lartë prej palëve, deklarohet prej tyre se që ajo është në përputhje të plotë me vullnetin e tyre të lirë dhe nënshkruhet rregullisht e në mirëbesim, në bazë të ligjit.

PALA SHITËSE

SKËNDER PASHAJ

Skender Pashaj 

PALA BLERËSE

IGLI PULLEJA

Igli Pulleja 